



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË
INDUSTRIËS DHE ENERGJISË**

Nr. 5406 / prot.

Tiranë, më 16 . 7 . 2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.617, datë 02.04.2001.

SHOQËRISË "SHEBENIKU" SHPK
Rruga "Çermetikë" Banesë Private, Kati I-rë, Librazhd

Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT
NË MINIERA**
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë

Shoqëria "Shebeniku" shpk është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.617, datë 02.04.2001, për mineral kuarci, në objektin "Lunik", Librazhd.

Nga struktura përgjegjëse AKBN, me shkresën nr.5826, datë 27.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5406, datë 01.08.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.617, datë 02.04.2001, për mineral kuarci, në objektin "Lunik", Librazhd, për arsye se nuk janë kryer pagesat e rehabilitimit vjetor për vitin 2014-2015, dhe për vitin 2017-2018, përcaktuar sipas pikës 5, të nenit 31, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Leja nr.617, datë 02.04.2001, është dhënë në përputhje me Ligjin nr.7796, datë 17.02.1994 "Minerar të Shqipërisë", të ndryshuar i cili është shfuqizuar me ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në germën "ç", të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje

revokohet) të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.617, datë 02.04.2001, për mineralin kuarci në objektin "Lunik", Librazhd, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë të ditur se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.617, datë 02.04.2001, për mineral kuarci në objektin "Lunik", Librazhd.

Në zbatim të nenit 49, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitetet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

